



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 331/1 prot.

Tiranë, më 12. 09. 2023

**V E N D I M**

**Nr. 182, datë 12. 09. 2023**

Bazuar në pikën 11<sup>1</sup>, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

**K O N S T A T O N:**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gjerat "b", dhe pika 3 e këtij neni, nenit 33 të Ligjit 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit, për të shqyrtuar ankesën nr. 137, datë 12.09.2022, që i përket ankuesit Fondacioni "Së Bashku", në të cilën pretendohet për diskriminim të personave me aftësi të kufizuara nga Bashkia Vorë lidhur me garantimin e aksesueshmërisë dhe përshtatshmërisë së trotuareve në territorin e Bashkisë.

Bazuar në nenin 33/10 të Ligjit 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, në përfundim të procedurës së hetimit, Komisioneri ka dalë me Vendimin nr. 200, datë 07.11.2022, me anë të të cilit ka vendosur:

1. *Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Vorë, në lidhje me aksesueshmërinë e këtyre personave në aksin rrugor, rruga "Unaza".*
2. *Në referim të pikës 1, Bashkia Vorë, të marrë masa të menjëhershme për:*
  - a. *Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në aksin rrugor, rruga "Unaza", sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008, "Për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara" dhe nr. 1074, datë 23.12.2015 "Për përcaktimin e masave për*

---

<sup>1</sup> Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

*mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.*

- b. Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.*
- 3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Vorë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.*
- 5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.*

Përsa më sipër, në vijim të komunikimit zyrtar lidhur me zbatimin e Vendimit nr. 200, datë 07.11.2022, Komisioneri u vu në dijeni nga ana e Bashkisë Vorë, me shkresën nr. 6375/2 prot., datë 19.12.2022, me anë të së cilës u informua ndër të tjera se: “

- Përsa i përket aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, të rrugëve/trotuareve të rikonstruara gjatë 5 viteve të fundit në Bashkinë Vorë janë përmbushur standartet për të ofruar shërbime publike lidhur me mjetet ndihmëse lëvizëse për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara;*
- Në të gjitha projektet për ndërtimet dhe strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese të miratuara nga Bashkia Vorë, janë marrë parasysh masat për të eliminuar pengesat dhe barrierat në ndërtesa, rrugë, transport dhe fasilite të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, qendrat shëndetësore apo ambientet e punës...;*
- Gjithashtu, Bashkia Vorë nuk ka asnjë fond të parashikuar në Buxhet në lidhje me personat me aftësi të kufizuara.”*

Në këtë kuadër, për zbatimin e vendimit të sipërcituar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 331 prot., datë 02.03.2023 kërkoi nga ana e Bashkisë Vorë të merren masa për rishikimin e buxhetit dhe parashikimin e fondeve për plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në aksin rrugor, rruga “Unaza”, si dhe hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

Në përgjigje përsa sipërcituar, Bashkia Vorë, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë provë apo informacion sa i përket marrjes së masave konkrete lidhur me zbatimin e vendimit nr. 200, datë 07.11.2022 të KMD-së.

Rezultoi e provuar se, Bashkia Vorë, në cilësinë e subjektit të gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese, nuk ka marrë masa për zbatimin e vendimit nr. 200, datë 07.11.2022, të Komisionerit. Në këtë mënyrë, Bashkia Vorë, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 32, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33, pika 13, të ligjit të sipërpërmendur, shoqërohet me marrjen e masave administrative, gjobë. Për personat juridik, siç është në rastin konkret Bashkia Vorë, ky nen përcakton shkrehimisht: “Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”:..... b) personi juridik nga **60.000 deri në 600.000 lekë;.....**”.

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se Bashkia Vorë, është në shkelje të parashikimeve të bëra në pikën 11, të nenit 33, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pasi nuk ka zbatuar Vendimin nr. 200, datë 07.11.2022 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në lidhje me masën e gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku sanksionohet se: “12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni.”

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e mësipërme për përcaktimin e masës së gjobës dhe bazuar në: faktin që, shkelja e konstatuar prek një komunitet personash; faktin që, personat me aftësi të kufizuar të cilët diskriminohen nga shkelja e konstatuar, janë një komunitet vulnerabël; faktin që, Bashkia Vorë është përsëritëse në konsumimin e shkeljeve të së njëjtës natyrë, në disa raste; Komisioneri, arrin në përfundimin se, Bashkia Vorë duhet të gjobitet me 200.000 (dyqind mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit nr. 200, datë 07.11.2022.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 32/1, germa “ç”, neni 33, pikat 11, 12, 13/b, 14 dhe 33/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

- 1.** Bashkia Vorë, të gjobitet në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit nr. 200, datë 07.11.2022 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- 2.** Gjoha të ekzekutohet dhe të derdhet në Buxhetin e Shtetit jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit, me kërkesë të Komisionerit.
- 3.** Pagesa e vlerës së gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.
- 4.** Zbatimi i Vendimit nr. 200, datë 07.11.2022 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda shtatë ditëve nga marrja dijani për sanksionet, sjell shfuqizimin e tij.
- 5.** Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**